



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 29.7.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Blerta Deliu – Kodra, Ismet Beqiri, Blerim Shala dhe Albert Kinolli.

Munguan: Sasha Milosavleviq, Fatmir Limaj, Vjosa Osmani, Glauk Konjufca dhe Suzan Novobërdali .

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-217 për Azil, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-174 për financimin e subjekteve politike, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-058, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

10. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujerave, Planifikimit Hapesinor dhe ndertimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

11. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për të huajt, rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Projektligji për të huajt së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-219 për të Huajt, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-217 për Azil, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Azil rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

Projektligji për Azil së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-217 për Azil, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit rregullon bashkëpunimin ndërmjet të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe zbatimin e strategjive të përbashkëta të këtyre autoriteteve, në mënyrë që detyrat e parapara për këto autoritete dhe masat individuale që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin, monitorimin dhe bashkëpunimin përkatës ndërkombëtar, të përmbushen në mënyrë të duhur, efikase dhe efektive.

Projektligji për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis të BE- së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit përcakton dispozitat juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi për parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikuar si dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimi më njerëz.

Projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis të BE- së.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror ka për qëllim përcaktimin evitimin e konfuzioneve terminologjike që përfshijnë: kontrollin kufitar, kontrollin në pikat kufitare, mbikëqyrjen kufitare, kontrollin minimal, kontrollin e plotë dhe kontrollin e linjës së dytë.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për shtetësinë e Kosovës ka për qëllim të adresoj çështjet që kanë të bëjnë me fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë së Kosovës. Projektligji për shtetësinë e Kosovës së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-174 për financimin e subjekteve politike, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-058, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Plotësim Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-174 për financimin e subjekteve politike, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-058, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.

Projektligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr.04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryesuesi, e ftoi deputetin Albert Kinolli, referues të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli, tha Projektligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit rregullon parimet, organizimi dhe mbikëqyrja inspektuese, koordinimi i mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedura për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

Andaj, pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe ndërtimit, me amendamentet e Komisionit Funksional, , është në harmoni me Acquis të BE- së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lutfi HAZIRI